



BASHKIMI EVROPIAN

Delegacioni i Bashkimit Evropian

Shkup, 13 shkurt 2013

**Eveniment përfundimtarë për projektin nga IPA 2008:
*"Ndhmë teknike për implementimin e fazës së dytë të
projektit TETRA dhe furnizim të sistemit policor për
komunikim radio digjital "***

[SVR Shkup]

Fjalim
Ambasador Aivo Orav
Shef i Delegacionit të BE-së

E nderuara Ministresh Jankullovska,

Zonja dhe zotëri,

Kam nderë që sot me ju ta prezantojmë sistemin e zgjeruar për komunikim radio digjital për Ministrinë për punë të brendshme, i financuar nga Bashkimi Evropian.

Ndihma e siguruar nga Bashkimi Evropian synon ti rris standardet policore dhe ti bëj forcat policore me efikase dhe më me përgjegjësi. Reformat policore janë një nga sfidat më të mëdha të ndërmarra nga qeveria në rrugën drejtë integritit në BE.

Për këtë arsye, Bashkimi Evropian është përfshirë në mënyrë aktive në përkrahjen e procesit të reformave policore duke siguruar ndihmë teknike në pajtim me standardet e BE-së dhe praktikat më të mira, si edhe furnizim të pajisjes së domosdoshme.

Ideja për sistem të sigurt nacional për komunikim radio digjital lindi gati para 10 vite. Në vitin 2004, In 2004, ekspertët e BE-së the zbatuan një analizë gjithëpërfshirëse të instrumenteve ekzistuese për komunikim, dhe në bazë të rekomandimeve të tyre, u lidhën 20 pika kufitare me rrjetin për komunikim.

Në fazën e ardhshme, BE-ja investoi 9 milion euro për zhvillimin e sistemit për komunikim radio digjital të policisë, i njohur si TERTA faza e parë. Krijimi i rrjetit të sigurt nacional publik, përbëhej nga 38 stacione bazore, të cilat ofronin siguri dhe mbulim, si edhe bashkëpunim më të mirë ndërmjet agjencive.

Sot ne jemi duke e shënuar integrimin e suksesshëm të sistemit ekzistues me pajisjen e re nga TETRA fazës së dytë, në vlerë prej 5 milion euro. Në kuadër të këtij projekti, u ndërtuan 26 stacione bazore në gjithë vendin.

BE-ja me ciklin e radhës financiar do të vazhdoj me përkrahjen e Ministrisë për punë të brendshme, duke e financuar fazën e tretë të projektit TETRA në vlerë prej 4.5 milion euro. Pra, përkrahja e përgjithshme e BE-së në këtë segment do të arrijë deri në 21 milion euro.

Në fund, do të doja të theksoj se angazhimi i autoriteteve nacionale për ta lëvizur këtë proces përpara ka rëndësi vendimtare. Duke e marrë parasysh ndihmën para-aderuese, Qeveria ka rol aktiv në formulimin e projekteve sipas nevojave të tyre. Pronësia e procesit është një garanci për ndikim afatgjatë dhe qëndrueshmëri të rezultateve të arritura.

Ju faleminderit për vëmendjen tuaj.